



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
KUVENDI KOMUNAL - MALISHEVË / QKMF "Dr. SHPËTIM ROBAJ" NË MALISHEVË
Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

Në bazë të nenit 67 dhe 68 të Ligjit për Zyrat Publik Nr. 06/L-114, të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, në bazë të nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 si dhe në bazë të rekomandimit nr. 89, të datës: 06.06.2022 të DSHMS-së Komuna e Malishevës - QKMF "Dr. Shpëtim Robaj" shpall:

KONKURS PËR PLOTSIMIN E VENDEVE TË PUNËS.

Titulli i vendit të punës: Infermier/e i Përgjithshëm/e në QKMF- Dr. " Shpëtim Robaj" – Malishevë.

- **Infermier/e i/e Përgjithshëm/e 2 pozita**

Institucioni:	Komuna e Malishevës
Departamenti/ Drejtoria:	Drejtoria Për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale- QKMF
Lloji i pozitës:	Nëpunës i Shërbimit Publik
Numri i Pozitave	(2) një.
Titulli i mbikëqyrësit	Drejtori i QKMF-së
Grada/ Koeficienti	4.8
Kohëzgjatja e emërimit	Me kohë të pa caktuar
Periodha provuese	6 (gjashtë) muaj

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin e zyrtarëve publikë

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotëroj njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët.
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale.
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik.

Detyrat dhe përgjegjësitë.

- Pranon dhe triazhon pacientët në QKMF
- Përgatitë pacientët për vizitë mjekësore
- Kryen punë administrative shëndetësore
- Përgjigjet për participimin e pacientëve
- Kryen sipas nevojës punët e kartotekës, intervencës, patronazhit, terrenit dhe edukimit
- Bënë aplikimin e terapisë si dhe përcjelljen e shenjave vitale gjatë kohës së transportit të pacientëve,
- Bënë bartjen e pacientëve prej shërbimit deri në ambulant dhe anasjelltas

- Sipas urdhrit të shefit të mjekësisë familjare kryen edhe punë tjera
- Për punën e vet i përgjigjet Kryeinfermierit dhe Shefit të Sektorit të Mjekësisë Familjare.

Dokumentet e nevojshme:

- Të ketë të kryer fakultetin e Infermierisë së Përgjithshme- Bachellor ose diplomën e Shkollës së Mesme të Mjekësisë (kopjen e noterizuar).
- Licencën e punës me afat (kopjen e noterizuar).
- Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës, diploma duhet njihet nga MPB.
- Formulari i aplikimit i plotësuar
- Rezumeja personale (CV)
- Certifikatën e lindjes, (origjinali).
- Certifikatën që nuk është nënë hetime ose i dënuar (origjinali).
- Letërnjoftimin të fotokopjuar .
- Certifikatën e mjekut për punë (pas përzgjedhjes nga komisioni)
- Përvoja e punës (e dëshirueshme)

Dokumentet duhet të jenë në kopje dhe të noterizuara, siç janë të renditura më lart.


Afati dhe mënyra e aplikimit:

30 ditë nga dita e publikimit të konkursit mbetet vetëm njoftim, ndërsa konkursi mbetet i hapur 15 ditë, aplikacionet dorëzohen nga data 08.07.2022 deri me dt: 22.07.2022 Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyrën e Personelit në QKMF (ditëve të punës prej: 07 deri ora 15).

-Konkursi shpallet në linkun: <http://konkursi.rks-gov.net> si dhe në tabelën e shpalljeve në QKMF. Të gjitha njoftimet dhe shpalljet vendosen në tabelën e shpalljeve në QKMF.

-Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pa kompletuara nuk do të pranohen.

QKMF-Malishevë
Dt: 09.06.2022



Drejtori:
Dr. Afrim Krasniqi, Spc. Mjek Familjar